

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E SHËNDETËSISË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **206-24-2841-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Sigurimi Fizik i Objekteve të Institutit Special në Shtime**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	"Internat Security Association"SH.P.K.
NUI	601073042
Adresa	Mustafë Kruja nr.3
Vendi	PRISHTINË
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	049778877
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Fitim Gashi
Adresa elektronike	info@securityisa.org
Data e parashtrimit të ankesës	30.09.2024

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Sigurimi Fizik i Objekteve të Institutit Special në Shtime

Njoftimi për kontratë dt.2603.2024

Hapja e planifikuar e tenderit me dt.26.04.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kërkesa për rishqyrtim e fundit me dt.21.09.2024.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1

Neni 7

Neni 10

Të Nderuar

Meqenëse se ne jemi kompani me interes në këtë AP po e parashtrojmë këtë ankesë duke pasqyruar se kompania jonë ka dalë me një ofertë të detajuar përmes një analize të kërkuar në dosjen e tenderit ku kanë qenë të përfshira të gjitha obligimet ligjore të dala nga ligji i punës së Republikës së Kosovës dhe veqanarisht neni 56 të këtij ligji të cilën kërkesë e kemi përmbushur në tërësi sipas kërkesës së dhënë të dosja e tenderit nga AK respektivisht të ankesës 1 specifikimet teknike të detyrueshme të cilën po e bashkëngjeshim këtu me shkresën për të dëshmuar më tej se OE Major nuk i plotëson as për së afërmi këto kërkesa të përlogaritje së cmimit në ofertën e tij .

“Ofruesi i Shërbimeve gjatë realizimit të kontratës do të respektoj Ligjin e Punës Nr. 03/L-212 në fuqi si dhe Ligjin për Shërbime Private të Sigurisë 04/L-004, të Republikës së Kosovës. Sipas nenit 27 të ligjit të punës - Orët e punës ndërmjet orës 22:00 dhe 6:00 numërohen si punë nate. Ndërsa sipas nenit 56 të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si: 30 % në orë për punë gjatë natës; 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe 50 % në orë për punë gjatë fundjavës.”

Kërkohet që kompania fituese të ketë minimumin 4 (punëtore) punëtor.

Orari i punës

• Instituti Special i Shtimes 24 ore / 7 dite te javës.

Andaj me një llogaritje të thjeshtë e cila nuk ka ndonjë komplikim në llogaritje OE I shpallur fitues nuk ka llogaritur në kërkesat e AK e të cilat po i dëshmojmë me një kalkulim i cili është i thjeshtë që dëshmon tërësisht ankesën tonë:

Paga e një punëtori është kërkuar të jetë 350 euro netto pagë paga bruto është në vlerë prej :

Paga netto 350 = paga bruto 385.36 euro ku janë të përfshira vetëm kontributet e punëmarrësit pastaj kalkulojmë pushimin vjetor 385.36 në muaj 29.19

Kalkulojmë më tutje 385.36+29.19 euro = 414.55 euro shtojmë kontributet nga punëmarrësi 20.73 euro që një pagë gjithsej vetëm me pushim vjetor kushton 414.55+20.73 euro 435.28 e që bëjnë $435.28 \times 4 = 1741.11$ euro x 36 muaj 62679.96

Llogarisim TVSH-në 18%= 11282.39

Totali i pagave plus tvsh 62679.96+11282.59= 73962.35 euro kurse oferta e OE fitues është nën këtë vlerë 73958.40 euro duke mos vazhduar më tej kalkulimin sipas kërkesës së AK (ecila është e qartë) më lartë OE I shpallur fitues nuk ka kalkuluar fare as orët shtesë të natës, as festat as vikendet obligim ky i dal me kërkesë të AK Andaj kërkojmë që ky AP të anulohet dhe të kthehet në rivlersim sepse jemi i vetmi OE i cili ka bërë të gjitha llogaritjet konform kërkesës së dosjes së tenderit të vendosura nga AK.

AK ka refuzuar kërkesën tonë të bazuar për rishqyrtim me pretekstin se ne jemi duke kryer shërbimet me kushte të njëjta, mirëpo kushtet e vendosura në kontratën e negociuar nuk janë të njëjta me

kërkesat në dosjen e tenderit për të cilin po bëjmë ankesën. Së pari paga minimale e kërkuar në kontratën e negociuar është 300 euro netto dhe ka një dallim prej 50 euro me pagën e kërkuar 350 euro netto në këtë AP, dhe normal që cmimi varion në kalkulim (bashkëngjitur gjeni edhe analizën financiare të kontratës së negociuar ku kemi llogaritur njësoj të gjitha obligimet e kërkuara), dhe ky nuk mund të konsiderohet si një arsye për refuzim të kërkesës sonë për rishqyrtim.

Me këtë veprim AK ka bërë shkeljet e neneve të përmendura në këtë ankesë dhe edhe njëherë kërkojmë nga OSHP që ankesa jonë të mirret si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlersim.

Neni 27
Neni 28
Neni 51
Neni 52
Neni 59

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mundesia e shperblimit me kontrate dhe shpenzimet administrative

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*